

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	5 interpelanca urgjente/ Ç'pritet të ndodhë të enjten në Kuvend, zbardhet rendi i ditës
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/15/5-interpelanca-urgjente-cpritet-te-ndodhe-te-enjten-ne-ku-vend-zbardhet-rendi-i-dites/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:10:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:05:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c929eae3f499990377f8650514b50f1c6ff29cf8e321e76e4eab39ff0109545b
TEKSTI	d7dfa0404156fc6dc67c5ea9fd827a025040e727c2f62f4844879c85b36c3914
PAMJA	c56a9c24664936f6c93f4d7106b343658406bc5b1d0ff07749b79484e30811ae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2024cf85ee0e50e18ee2c8f1dc66223f48f23b7c7f5a2a3a7eeeab3ab73d0b27
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcd39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2024cf85ee0e50e18ee2c8f1dc66223f48f23b7c7f5a2a3a7eeeab3ab73d0b27

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

5 interpelanca urgjente/ Ç'pritet të ndodhë të enjten në Kuvend, zbardhet rendi i ditës

19:05 : 15/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Kuvendi i Shqipërisë do të zhvillojë të enjten, në orën 10:00, seancën plenare të radhës.

Sipas rendit të ditës të publikuar për mediat, seanca do të nisë me miratimin e procesverbalit të seancës plenare të datës 8 shtator, ndërsa në rendin e ditës janë parashikuar **pesë interpelanca urgjente** të kërkuara nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

E para është me Ministrin e Mjedisit, Sofjan Jaupaj, e dyta me Ministrin e Punëve Brendshme, ndërsa interpelancat e tjera janë me Ministren e Arsimit, Mirela Kumbaro, dhe Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahiu.

Po ashtu, deputeti Blendi Himçi ka kërkuar një interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi.

Në vijim, deputetët do të shqyrtojnë një sërë projektligjesh, mes tyre projektligjin për ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, të bërë në Hagë më 16 dhjetor 2025.

Lexo edhe:

[Seanca plenare në Kuvend/ Zbardhet rendi i ditës, a do ta thyjë PD bojkotin?](#)

[Draft-rezoluta, Kuvendi i Shqipërisë shpall Iranin shtet terrorist](#)

Në rendin e ditës është përfshirë edhe projektligji për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës.

Kuvendi do të shqyrtojë gjithashtu projektligjin për pranimin e vendimit të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit për ndryshimin e nenit 36 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjë të Tavolinës, 2015.

TË GJITHA



5 interpelanca urgjente/ Ç'pritet të ndodhë të enjten në Kuvend, zbardhet rendi i ditës

19:05 : 15/09/2026



Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?

18:52 : 15/09/2026



"Dita 5"/ Bardhi: SPAK po hesht për rëndimin e masës ndaj Ballukut, pse po i jep kohë Ramës?

18:41 : 15/09/2026



Tre shenja lënë pas periudhën e vështirë

18:32 : 15/09/2026



Skandali/ Policia rrugore iu hap rrugën kamionëve të "Alesio-2014" në orarin e ndalimit të qarkullimit

18:25 : 15/09/2026



Sot protesta e 108-të kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh

18:20 : 15/09/2026



Italia zgjat pezullimin e marrëveshjes së Shengenit për 15 ditë të tjera, Madridi: Absurde dhe e panevojshme

18:12 : 15/09/2026

Një tjetër pikë e rëndësishme e rendit të ditës është projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ky projektligj kërkon shumicë të cilësuar votash për miratim.

Në seancë do të shqyrtohet edhe projektligji “Për disenjot”, si dhe projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”.

Në fund të seancës do të hidhen për votim tre projektvendime që lidhen me ndryshimet në kryesinë, anëtarësinë dhe anëtarët zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.

Seanca do të mbyllet me diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës. Sipas Rregullores së Kuvendit, çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta, ndërsa nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.

Etiketa: kuvendi i shqiperise seane plenare

Lajme të lidhura



Seanca plenare në Kuvend/
Zbardhet rendi i ditës, a do ta
thyejë PD bojkotin?

08:58 : 20/07/2026



Draft-rezoluta, Kuvendi i
Shqipërisë shpall Iranin shtet
terrorist

16:52 : 16/03/2026



Interpelancë për "Duranën" dhe
ligji për AKSHI-n/ Ç'pritet të
ndodhë sot në Kuvend, zbardhet
rendi i ditës

08:59 : 19/02/2026



Çështja "Balluku"/ Balla: Ja pse
po e vonojmë mbledhjen e
Këshillit të Mandateve

15:44 : 12/02/2026



PS kërkon, Kuvendi miraton:
Nesër seancë për Bordin e
Paqes dhe Ramën

21:45 : 21/01/2026



Peleshi do të hapë TV në Kuvend
me kosto 500 mijë euro

19:51 : 20/01/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

